



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

Duke u bazuar në Strategjinë nacionale për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali në Republikën e Kosovës 2022-2026, Planit të Veprimit për zbatimin e strategjisë për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali në Republikën e Kosovës 2022-2026, Shkresës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal nr. 0-231 të datës 30.03.2026, Komuna e Podujevës shpall:

KONKURS

Për plotësimin e pozitave për anëtar të Komitetit Komunal Veprues nga radhët e organizatave të shoqërisë civile

Zyra për Komunale për Komunitete dhe Kthim

I. Titulli i vendit të punës: Anëtar i Komitetit Komunal Veprues,

Numri i Pozitës: Katër (4) përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile që veprojnë në fushën e komuniteteve rom dhe ashkali.

Detyrat dhe roli i anëtarit të Komitetit Komunal Veprues:

- Të bashkëpunoj me autoritetet lokale dhe përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile për zbatimin dhe monitorimin e strategjisë nacionale për avancimin e komuniteteve rom dhe ashkali në Komunën e Podujevës ;
- Të merr pjesë aktive në takimet e Komitetit Komunal Veprues;
- Të monitoroj aktivitetet e parapara në planin lokal të veprimit për avancimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Podujevës;
- Të kontribuojë në inicimin e miratimit të politikave tjera lokale, të cilat do të kontribuonin në zbatimin planit lokal të veprimit për avancimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Podujevës;
- Të koordinojë aktivitetet me institucionet e nivelit qendror dhe organizatat e shoqërisë civile për zbatimin e planit lokal të veprimit për avancimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Podujevës;
- Të zhvillojë aktivitete me partnerë tjerë për alokime të fondeve për zbatimin e planit lokal të veprimit për avancimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Podujevës;

II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve

Përzgjedhja e kandidatëve nga organizatat e shoqërisë civile do të jetë publike dhe transparente. Do të merren parasysh kriteret, si vijon:

- Kandidatët nga radhët e organizatave të shoqërisë civile të cilët punojnë me sukses më shumë se tri (3) vite në fushën e avancimit të komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare;
- Kandidatët nga radhët e organizatave të shoqërisë civile të cilat kanë programe/projekte të qëndrueshme në fushën e avancimit të komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare;
- Kandidatët nga radhët e organizatave të shoqërisë civile që monitorojnë aktivitetet e komuniteteve joshumicë në Komunën e Podujevës;
- Kandidatët nga radhët e organizatave të shoqërisë civile që kanë njohuri të mjaftueshme për monitorimin dhe vlerësimin e planeve dhe projekteve të caktuara;

Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:

- Formulari i aplikimit i plotësuar (merret në komunë – Qendra për Shërbime me Qytetarë);
- Rezymeja personale (CV);
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë);
- Certifikatën e regjistrimit të organizatës që përfaqësojnë;
- Dëshmi të përvojës të punës.

III. Mosplotësimi i saktë dhe i qartë i formularit të aplikimit, aplikacionet e pakompletuara dhe ato që dorëzohen pas afatit të konkursit nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen.

Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje dhe nuk kthehen. Ndërsa, origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.

IV. Afati dhe mënyra e aplikimit

Konkursi mbetet i hapur **15 ditë** nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, duke filluar nga data e publikimit më 03.04.2026 deri më datën 17.04.2026.

Aplikacioni i kompletuar (me të gjitha dokumentet e kërkuara) duhet të dorëzohet përmes protokollit, përkatësisht përmes Qendrës për Shërbime me Qytetarë, në objektin e Komunës së Podujevës.